

**AKTIVITETI KËRKIMOR SHKENCOR I  
DEPARTAMENTIT TË SHKENCAVE JURIDIKE  
PËRGJATË PERIUdhËS AKADEMIKE 2013 - 2018**

**Konferenca studentore me temë “Njohja me të Drejtën dhe Zhvillimi në Shkollë dhe Komunitet”, organizuar nga Departamenti i Shkencave Juridike në bashkëpunim me Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme në “Albanian University” - 01 Shkurt 2013.**

Gjatë muajit Shkurt, Departamenti i Shkencave Juridike ka organizuar konferencën studentore me temë “Njohja me të Drejtën dhe Zhvillimi në Shkollë dhe Komunitet”, me përfshirjen e studentëve të programit të studimit në “Shkenca Juridike” si dhe studentëve të Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme.

Objekt i kësaj konference kanë qenë kryesisht, punimet dhe referimet e studentëve të cilët ndjekin vitin e fundit të studimit në ciklin Bachelor dhe në nivel Master. Studentët arritën të përcillnin me anë të punimeve, mendimin e tyre kritik duke analizuar kuadrin ligjor Shqiptar.

**Konferenca Shkencore Ndërkombëtare me temë “Ligji Penal dhe Zbatimi i tij”, organizuar nga Departamenti i Shkencave Juridike në “Albanian University” në bashkëpunim me University of Budapest “CORVINUS” dhe Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda - 10 Mars 2014.**

Gjatë muajit Mars, Departamenti i Shkencave Juridike në “Albanian University” në bashkëpunim me University of Budapest “CORVINUS” dhe Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, organizoi Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë “Ligji Penal dhe Zbatimi i tij”.

Sistemi i drejtësisë është një nga shtyllat themelore mbi bazën e të cilave ngrihet dhe funksionon shteti i së drejtës. Shqipëria ka mbi dy dekada që po përpiqet që të integrohet në familjen evropiane, ku ndërtimi i një drejtësie të pavarur dhe efektive, është një nga problemet më të rëndësishme. Në të gjitha Progres Raportet e Komisionit Evropian, përfshirë dhe atë të vitit 2013, si dhe përfshirë rekomandimet e dhëna nga Këshilli i Ministrave të Jashtëm të Bashkimit Evropian në Dhjetor 2013, drejtësia është një nga fushat problematike të vendit tonë.

Sigurimi i një drejtësie të pavarur dhe efektive, është i varur nga një numër i madh faktorësh. Një prej këtyre faktorëve është edhe pasja e një legjislacioni të plotë dhe bashkëkohor. Ligji penal nga ana e tij, përbën një pjesë të rëndësishme të legjislacionit të çdo shteti. Qëllimi i kësaj Konference Shkencore, është pikërisht, trajtimi i ligjit penal, në të gjitha aspektet e mundshme, si një nga kontribuesit më me vlerë në sigurimin e një drejtësie efektive dhe të pavarur.

Konferenca kishte kryesisht karakter akademik, ku u synua të trajtohen probleme të ndryshme që kanë të bëjnë me ligjin penal dhe zbatimin e tij, qoftë ligjin material ashtu edhe ligjin procedural penal. Por, përveç çështjeve akademike, konferenca synoi të trajtoj edhe çështje me karakter praktik, ku u përfshin vendime gjyqësore të Gjykatave të Shkallës së Parë, të Gjykatave të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë, që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit penal në Shqipëri. Një theks të veçantë, konferenca i vuri edhe trajtimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, si dhe vendimeve të Gjykatës së Strasburgut, të cilat kanë të bëjnë sidomos me garantimin e një procesi të rregullt ligjor.

Së fundi, konferenca synoi që të trajtojë aspekte të veçanta që lidhen me përafrimin e ligjit penal Shqiptar me atë të Bashkimit Evropian, si një nga kushtet për integrimin e vendit tonë në familjen evropiane.

**Konferenca Shkencore Ndërkombëtare me temë “Shteti, Shoqëria, e Drejta: Bashkëpunimi Rajonal”, organizuar nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore në “Albanian University” në bashkëpunim me Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe Qendrën për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Ballkanike – 23, 24 Maj 2014.**

Gjatë muajit Maj, Fakulteti i Shkencave Shoqërore në “Albanian University” në bashkëpunim me Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe Qendrën për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Ballkanike organizoi Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë “Shteti, Shoqëria, e Drejta: Bashkëpunimi Rajonal”.

Bashkëpunimi rajonal po përhapet gjerësisht, dhe po ashtu janë në rritje edhe marrëveshjet e ndryshme institucionale, duke përfshirë organizata gjithëpërfshirëse rajonale, organizata sektoriale rajonale, rrjete dhe bashkëpunim rajonal. Duke pasur besim që bashkëpunimi rajonal mund të përmirësohet vetëm nëpërmjet inkurajimit aktiv të bashkëpunimit rajonal institucional dhe privat, konferenca ka si

objektiv gjetjen e rrugëve të reja, apo përmirësimin e atyre ekzistueseve, për arritjen e këtij qëllimi.

Temat e referuara në konferencë u përqëndruan kryesisht në trajtimin e temave të mëposhtme:

1. Shteti i së Drejtës;
2. Sfidat e Konsolidimit të Demokracisë;
3. Reformat kryesore në sistemin e Shtetit të së Drejtës;
4. Shoqëria dhe Sfidat e të Drejtës;
5. Bashkëpunimi Rajonal mbi të Drejtën Penale (Krimi i organizuar, pastrimi i parave, korrupsioni)
6. Drejtësia dhe Investimi në Edukim, nëpërmjet Bashkëpunimit Rajonal;
7. E Drejta Ndërkombëtare dhe Bashkëpunimi Rajonal;
8. Organizata Ndërkombëtare dhe Rajonale;
9. Sistemet partiake në Rajon: Ndryshimet dhe të Përbashkëtat;
10. Shtetësia dhe Kombësia;
11. Shoqëria e Informacionit. Qeverisja elektronike. Tregtia elektronike.
12. Historia e Rajonit;
13. Evropa juglindore, zhvillimet dhe proceset e përbashkëta;
14. Perspektiva e integritimit në BE. Mësime nga praktikat më të mira;
15. Tranzicioni politik dhe ekonomik;
16. Administrata publike. Reformat dhe politikat publike;
17. Zhvillimi i qëndrueshëm rajonal;
18. Ndihma në Tranzicion dhe ndërtimin e Institucioneve;
19. Zhvillimi Rajonal Financiar / Politikat Rajonale Buxhetore;
20. Shoqëria Civile dhe problemet Gjimore në Evropën Juglindore;
21. Manaxhimi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme;

**Konferencë Shkencore Ndërkombëtare “Social Sciences of the Nowadays – Innovation Research for the Social Sciences, Technology and development” - 06 Qershor 2014**

Gjatë muajit Qershor, dhjetë pedagogë të departamentit morrën pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare të organizuar nga “Albanian University” në bashkëpunim me UNIVERSITA DEGLI STUDI DI URBINO “CARLO BO”, “INDCT”, “Mediterranean Center of Social and Educational Research”, “NATIONAL TAICHUNG UNIVERSITY OF SCIENCE AND TECHNOLOGY” si dhe “THE INSTITUTE FOR ADVANCED PSYCHOLOGICAL TRAININGS”.

Synimet e kësaj Konference Multidisciplinore Shkencore Ndërkombëtare me temë *“Social Sciences of the Nowadays – Innovation Research for the Social Sciences, Technology and development”* ishte të stimulonte debatin ndërmjet akademikëve, ekspertëve, përfaqësuesve të organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare, grupeve të interesit, etj., për të bërë të mundur prezantimin e rezultateve më të rëndësishme të kërkimeve të tyre për çështje, probleme dhe procese të një interesi madhor. Pjesëmarrja në konferencë ka drejtuar pedagogët e departamentit për studime në fusha specifike, duke marrë pjesë me punime të mirëfillta shkencore.

Konferenca u zhvillua në ambjentet e “Albanian University”.

**Leksion i hapur me temë “A është Toleranca Fetare Arsyeja e Mbrojtjes së Hebrenjëve në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore?”, organizuar nga Departamenti i Shkencave Juridike në “Albanian University” – 02 Prill 2015.**

Në muajin Prill, Departamenti i Shkencave Juridike në bashkëpunim me Departamentet e tjera të Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe Zyrën e Orientimit të Studentëve dhe Zhvillimit të tyre në Karrierë në “Albanian University”, organizoi leksionin e hapur me temë: *“A është Toleranca Fetare Arsyeja e Mbrojtjes së Hebrenjëve në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore?”*.

Prof. Dr Efrat Kedem Tahar, pedagog në University of Haifa, Israel diskutoi me studentët e ciklit të parë të studimit, Bachelor në “Shkenca Juridike” këto tema kryesore:

1. Familjet Shqiptare që strehuan hebrenjtë gjatë luftës së dytë botërore;
2. Holokausti dhe historia famëkeqe, për shfarrosjen e njerëzve në historinë e botës;
3. Politika e vendeve të Europës dhe historia politike e Shqipërisë gjatë luftës së dytë botërore;
4. Kampet e përqendrimit dhe statistikat e holokaustit.

Në këtë leksion morrën pjesë:

Dr. Bedri Kola - Drejtues i Departamentit të Shkencave të Edukimit dhe Anglishtes;

Dr. Bledar Ilia - Drejtues i Departamentit të Shkencave Juridike;

Dr. Julian Çota - Drejtues i Departamentit të Shkencave Politiko -Administrative;

Dr. Eglantina Dervishi - Drejtuese e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme;

Dr. Olsi Lelaj - Pedagog i lëndës “Antropologji Juridike” pranë Departamentit të Shkencave Politiko - Administrative.

Studentët nëpërmjet pyetjeve, shfaqen interes për të njohur:

1. Historitë e familjeve Shqiptare që strehuan hebrenjtë gjatë 50 viteve diktaturë, histori kjo që u mbajt e fshehur në këtë periudhë historike;
2. Muzeun e Holokaustit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe statistikën e kampeve të përqendrimit në territoret evropiane, të kontrolluara nga Gjermania;
3. Arkivat e Shqipërisë mbi holokaustin.

**Konferenca studentore me temë “Ligjshmëria - Konceptimi dhe Zbatimi në Marrëdhëniet Shoqërore”, organizuar nga Departamenti i Shkencave Juridike në bashkëpunim me Departamentet tjera në Fakultetin e Shkencave Shoqërore në “Albanian University” - 08 Prill 2015.**

Gjatë muajit Prill, Departamenti i Shkencave Juridike ka organizuar në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Politiko - Administrative, Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme dhe Departamentin e Shkencave të Edukimit dhe Anglishtes konferencën e pestë studentore me temë “Ligjshmëria - Konceptimi dhe Zbatimi në Marrëdhëniet Shoqërore”, me përfshirjen e studentëve të programit të studimit Bachelor në “Shkenca Juridike”, Bachelor në “Psikologji e Përgjithshme” dhe “Shkenca Politiko - Administrative.

Objekt i kësaj konference kanë qenë punimet dhe referimet e studentëve të viteve të fundit të nivelit Bachelor, të cilët përcillnin mendimin e tyre kritik dhe analizën mbi kuadrin ligjor shqiptar në fusha të ndryshme shoqërore. Në konferencë morën pjesë 7 studentë të cilët përfaqësuan Departamentin e Shkencave Juridike.

**Leksion i hapur me temë “Korrelacioni Mjekësi Ligjore, Kriminalistikë në Hetimin e Krimit”, organizuar nga Zyra e Orientimit të Studentëve dhe Zhvillimit të tyre në Karrierë në “Albanian University” në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Shoqërore - 08 Qershor 2015.**

Në muajin Qershor, Zyra e Orientimit të Studentëve dhe Zhvillimit të tyre në Karrierë në “Albanian University”, e mbështetur nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore organizoi leksionin e hapur me temë “Korrelacioni Mjekësi Ligjore, Kriminalistikë në Hetimin e Krimit”.

Në këtë aktivitet, me interes kryesisht për studentët e Departamentit të Shkencave Juridike pedagogu Dr. Sabri Hoxha, ekspert kriminalist diskutoi këto tre tematika kryesore:

1. Vlera e Koordinimit midis dy fushave "Mjekësi Ligjore" dhe "Kriminalistikë", në përgatitjen e kuadrove për hetimin e krimit;
2. Sfida e organeve hetimore kundrejt formave të reja të evoluimit të krimit;
3. Përgatitja profesionale, një sfidë e re për organet e drejtësisë.

Në këtë leksion morrën pjesë gjithashtu edhe Prof. Asoc. Dr Luan Veliqoti, ekspert mjekoligjor dhe Ma. Nikoll Rica, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

**Leksion i hapur me temë “Organizimi dhe Funksionimi i Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, organizuar nga Departamenti i Shkencave Juridike në “Albanian University” – 11 Mars 2016.**

Në muajin Mars, Departamenti i Shkencave Juridike i mbështetur nga Departamenti i Shkencave Politiko - Administrative në “Albanian University” organizoi leksionin e hapur me temë “Organizimi dhe Funksionimi i Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”.

Në këtë aktivitet, me interes në formimin e juristëve të ardhshëm, ishte i ftuar Kryetari i Gjykatës Kushtetuese Z. Bashkim Dedja, i cili diskutoi me studentët e programit të studimit Bachelor dhe master mbi:

1. organizimin e Gjykatës Kushtetuese;
2. juridiksionin e veçantë të Gjykatës Kushtetuese, për kontrollin nga ana e kësaj gjykate të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore;
3. procedurën që ndjekin ankesat që i drejtohen Gjykatës Kushtetuese;
4. vendimet e Gjykatës Kushtetuese;
5. kuptimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe jurisprudenca kushtetuese.

**Leksion i hapur me temë “Gjykata e Krimeve të Rënda dhe Perspektiva e saj në Kuadër të Reformës në Drejtësi”, organizuar nga Departamenti i Shkencave Juridike në “Albanian University” - 13 Maj 2016.**

Në muajin Maj, Departamenti i Shkencave Juridike organizoi leksionin e hapur me temë “Gjykata e Krimeve të Rënda dhe Perspektiva e saj në Kuadër të Reformës në Drejtësi”.

Në këtë aktivitet, ishte i ftuar Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Z. Sandër Simoni i cili diskutoi me studentët e Departamentit të Shkencave Juridike mbi perspektivën e kësaj gjykate në kuadër të reformës në drejtësi.

Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Z. Sandër Simoni, bëri një rezume të gjithë veprimtarisë së kësaj gjykate që nga krijimi i saj e deri në ditët e sotme, duke vënë theksin tek impakti që veprimtaria e kësaj gjykate ka në antarësimin e Shqipërisë në strukturat euro – atlantike.

**Konferenca studentore me temë “Sfidat e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë në Funksion të Integrimit në Bashkimin European”, organizuar nga Departamenti i Shkencave Juridike në bashkëpunim me Departamentet e tjera të Fakultetit të Shkencave Shoqërore në “Albanian University” – 23 Maj 2016.**

Në muajin Maj, Departamenti i Shkencave Juridike në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Politiko-Administrative, Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes dhe Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme organizojnë Konferencën Studentore me temë “Sfidat e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë në funksion të integrimit në Bashkimin European”.

Në këtë konferencë morrën pjesë katër studentë të vitit të tretë të programit të studimit Bachelor në “Shkenca Juridike”.

**Leksion i hapur me temë “Çfarë është Erasmus + dhe si të bëhemi pjesë?”, organizuar nga Zyra e Erasmus+ në bashkëpunim me “Albanian University” – 24 Nëntor 2016.**

Gjatë muajit Nëntor, Zyra e Erasmus+ në Shqipëri organizoi në ambjentet e “Albanian University” me pjesëmarrjen e studentëve nga tre fakultetet, leksionin e hapur me temë “Çfarë është Erasmus + dhe si të bëhemi pjesë?”.

Në këtë leksion studentët pjesëmarrës mund të merrnin informacion mbi çfarë është Erasmus +, kush mund të përfitojë, si financohet, si menaxhohet ky program, dokumentet që nevojiten për aplikim, procedurat që ndiqen për aplikime on-line etj.

Aktiviteti i organizuar në “Albanian University” u mbështet edhe nga Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, me qëllim dhënien e të gjithë informacionit të nevojshëm, studentëve të cilët duan të ndjekin ciklet e tjera të studimit në një

universitet jashtë vendit apo edhe atyre të interesuar të angazhohen jashtë vendit në trajnime apo aktivitete të tjera ekstrakurrikulare.

**Konferencë Shkencore Ndërkombëtare “Problemet dhe Sfidat e transformimit të Shoqërisë Shqiptare drejt Standarteve të Bashkimit European” - 09 Dhjetor 2016**

Në muajin Dhjetor, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në “Albanian University” në bashkëpunim me Universita di Romá “La Sapienza”, Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Ningbo Dahongying University organizuan Konferenca e 3-të Shkencore Ndërkombëtare “Problemet dhe Sfidat e Transformimit të Shoqërisë Shqiptare Drejt Standarteve të Bashkimit European”.

Në këtë konferencë Departamenti i Shkencave Juridike ishte bashkë-organizator me Departamentet e tjera të Fakultetit të Shkencave Shoqërore.

Synimet e kësaj Konference Multidisiplinore Shkencore Ndërkombëtare me temë “Problemet dhe Sfidat e Transformimit të Shoqërisë Shqiptare Drejt Standarteve të Bashkimit European” ishte të stimulonin debatin ndërmjet akademikëve, ekspertëve, përfaqësuesve të organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare, grupeve të interesit, etj., për të bërë të mundur prezantimin e rezultateve më të rëndësishme të kërkimeve të tyre për çështje, probleme dhe procese të një interesi madhor. Pjesëmarrja në konferencë ka drejtuar pedagogët e departamentit për studime në fusha specifike, duke marrë pjesë në konferencë me punime të mirëfillta shkencore. Konferenca u zhvillua në ambjentet e Tirana International Hotel dhe në ambjentet e “Albanian University”.

**Leksion i hapur me temë “Roli i Zyrës së të Drejtës së Autorit në Republikën e Shqipërisë në Zbatimin e Legjislacionit Përkatës”, organizuar nga Departamenti i Shkencave Juridike në “Albanian University” dhe Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA) - 13 Prill 2017.**

Në muajin Prill, Departamenti i Shkencave Juridike i mbështetur nga Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët në “Albanian University”, në bashkëpunim me Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA) organizuan leksionin e hapur me temë “Roli i Zyrës së të Drejtës së Autorit në Republikën e Shqipërisë në Zbatimin e Legjislacionit Përkatës”.

Në këtë aktivitet ishin të ftuar përfaqësues të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit të cilët diskutuan mbi rolin e Zyrës si dhe mbi të drejtat e autorit dhe zbatimin e ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to. Pjesëmarrës në aktivitet ishin stafi akademik i angazhuar në departament si dhe studentë kryesisht të Fakultetit të Shkencave Shoqërore.

**Konferenca studentore me temë “Konsolidimi i Shtetit të së Drejtës në Shqipëri. Nevoja për Reforma, Domosdoshmëria për Implementim”, organizuar nga Departamenti i Shkencave Juridike në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Politiko-Administrative në “Albanian University” - 31 Maj 2017.**

Në vazhden e ndjekjes së traditës në zhvillimin e konferencës studentore, edhe në vitin akademik 2016 - 2017 gjatë muajit Maj, Departamenti i Shkencave Juridike ka organizuar në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Politiko-Administrative konferencën studentore me temë “Konsolidimi i Shtetit të së Drejtës në Shqipëri. Nevoja për Reforma, Domosdoshmëria për Implementim”, me përfshirjen e studentëve të programit në Shkenca Juridike dhe Shkenca Politiko - Administrative.

Ky aktivitet ka si qëllim, aktivizimin e studentëve në aktivitetet ekstrakurrikulare dhe impenjimin e tyre drejt kërkimit shkencor.

Objekt i kësaj konference ishin punimet dhe referimet e studentëve të ciklit të parë të studimit Bachelor si dhe programet master profesional dhe master shkencor, të cilët përcollën mendimin e tyre kritik dhe analizën mbi kuadrin ligjor shqiptar në fusha të ndryshme shoqërore. Në konferencë morrën pjesë pesë studentë të Departamentit të Shkencave Juridike. Aktiviteti fizikisht u organizua në ambjentet e “Albanian University”.

**Konferenca e 4-të Shkencore Ndërkombëtare “Problemet dhe Sfidat e transformimit të Shoqërisë Shqiptare drejt Standarteve të Bashkimit European” - 22 Dhjetor 2017**

Në muajin Dhjetor, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në “Albanian University” në bashkëpunim me Universita di Romá “La Sapienza”, Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Kolegjin Universitar “Qiriazi” organizuan Konferenca e 4-të Shkencore Ndërkombëtare me temë “Problemet dhe Sfidat e Transformimit të Shoqërisë Shqiptare Drejt Standarteve të Bashkimit European”.

Në këtë konferencë Departamenti i Shkencave Juridike ishte bashkë-organizator me Departamentet e tjera të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, aktivitet në të cilin morrën pjesë nëntë pedagogë të angazhuar në Departamentin e Shkencave Juridike.

Synimet e kësaj Konference Multidisiplinore Shkencore Ndërkombëtare me temë *“Problemet dhe Sfidat e Transformimit të Shoqërisë Shqiptare Drejt Standarteve të Bashkimit European”* është të stimulojë debatin ndërmjet akademikëve duke ju mundësuar atyre pjesëmarrjen në më tepër aktiviteteve shkencore, ekspertëve, përfaqësuesve të organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare, grupeve të interesit, etj.

Ndërkohë qëllimi kryesor i konferencës është të sigurojë një qasje akademike dhe profesionale si dhe të nxisë diskutimin mbi zhvillimet e sotme më të rëndësishme në ekonomi dhe drejtësi në lidhje me problemet dhe sfidat e transformimit të shoqërisë drejt standarteve të Bashkimit European.

Përfshirja në proceset integruese të Bashkimit European është synimi kryesor për Ballkanin Perëndimor, përfshirë dhe Shqipërinë në rrugën për antarësim në BE.

Konferenca ka një shtrirje të dyfishtë, në studimet në fushat e drejtësisë dhe ekonomisë duke nxitur bashkëpunimin në punime shumë disiplinore. Konferenca u mbajt në ambjentet e Kolegjit Universitar “Qiriazi”.